

Studim i shkurtër i politikave 19/2018

Kriteret ligjore për emërimin e udhëheqësve të ndërmarrjeve publike, organeve rregullatore dhe të pavarura

Autorët: Jugoslav Gjorgjievski

Nëntor 2018



British Embassy
Skopje



*Ky publikim financohet nga UK aid nga Qeveria e Mbretërisë së
Bashkuar. Mendimet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht
pikëpamjet dhe politikat zyrtare të Qeverisë Britanike*

Impressum

Titull: Kriteret ligjore për emërimin e udhëheqësve të ndërmarrjeve publike, organeve rregullatore dhe të pavarura

Botues: Institutit për Demokraci
"Societas Civilis" - Shkup

Autor: Jugoslav Gjogjievski

Përkthim: Mustafa Peza

Dizajni: Dejan Kuzmanovski

Ky publikim është i disponueshëm në:

<http://www.idscs.org.mk>

Hyrje

Lëndë e kësaj analize janë ligjet dhe aktet nënligjore, ndryshimet, të pathënat e plota juridike dhe fushat e parregulluara, që kanë të bëjnë me punën dhe veprimin e ndërmarrjeve publike, ndërmarrjet në pronësi të plotë shtetërore, trupat e pavarura rregullatore, organet e pavarura shtetërore dhe organet e administratës shtetërore. Me këtë analizë është përfshirë edhe korniza juridike me të cilën rregullohet emërimi i anëtarëve të këshillave drejtues dhe të drejtorëve në ndërmarrjet publike, ndërmarrjet në pronësi të plotë shtetërore dhe trupa të pavarur rregullator, me fokus shtesë në mundësitë diskrecionale për emërim.

Analiza përfshin 173 organe publike, si dhe 48 ligje me të cilat është e rregulluar puna e këtyre organeve, mund të nxirret konkluzë se nuk ka qasje të vetme dhe të unifikuar si në raport me themelimin e këtyre ndërmarrjeve publike, ashtu edhe në raport me punën dhe udhëheqjen e

tyre. Gjithashtu mungon edhe klasifikim përkatës i organeve publike që e pamundëson përcjelljen sistematike të punës së tyre. Madje edhe në rastet kur ka rregullativë sistemore ligjore për një lloj të caktuar të organeve publike, siç janë ndërmarrjet publike dhe shoqatat tregtare në pronësi të plotë shtetërore, prapëseprapë ekziston fragmentim të rregullativës, si në vetë ligjet sistemore, por edhe me sjelljen e ligjeve shtesë për ndërmarrje të tërësishme shtetërore. Mundësia e gjerë të cilën e lënë ligjet, me akte interne (statute) të rregullohen çështje me karakter statusor janë një problem shtesë në raport me vendosjen e kornizës së qartë dhe precize për funksionimin e përditshëm të këtyre institucioneve.

Kornizë e përbashkët ligjore

Në aspektin e kuadrit ligjor të masave dhe aktiviteteve për parandalimin e korrupsionit në ushtrimin e pushtetit, autorizimet publike, detyra zyrtare dhe politika, masat dhe aktivitetet për parandalimin e konfliktit të interesave, masave dhe aktiviteteve për parandalimin e korrupsionit gjatë kryerjes së çështjeve me interes publik, duhet të kihet parasysh se Ligji për pengimin e korrupsionit i përfshin të gjitha organet publike që janë objekt i kësaj analize, në mënyrë që në këtë pjesë ka zgjidhje sistemore, ndërsa të gjitha problemet në zbatimin e këtij ligji, parimisht kanë të bëjnë me të gjitha organet e përfshira me analizën.

Në raport me performancën financiare, nuk ka një qasje të vetme në rregullimin e punës së organeve të përfshira nga kjo analizë. Në të vërtetë ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare me pronësi të plotë shtetërore, mbajtja e kontabilitetit, përgatitja dhe dorëzimi i llogarisë vjetore dhe pasqyrat financiare, i kryejnë në

pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe me standardet ndërkombëtare të miratuara të kontabilitetit dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar të publikuara në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nga ana tjetër organet e tjera shtetërore të përfshira me këtë analizë, në raport me punën financiare udhëheqjen e kontabilitetit, përgatitjen dhe parashtrimin e llogarisë vjetore dhe raportet financiare e bëjnë në pajtim me Ligjin për kontabilitet dhe shfrytëzuesit buxhetor.

Në raport me sistemin e kontrollit publik të brendshëm financiar i cili e përfshin menaxhimin financiar dhe kontrollin, revizionin e brendshëm dhe harmonizimin e tyre, të vendosur në pajtim me standardet ndërkombëtare për kontroll të brendshëm dhe revizion të brendshëm, si dhe kushtet dhe mënyrën e zbatimit të procedurës, si dhe kushtet dhe mënyrën e zbatimit të procedurës për dhënie të provimit për revizor të autorizuar të brendshëm në sektorin publik, për të gjitha organet e përfshira me këtë analizë aplikohet në Ligjin për kontroll të brendshëm financiar, i cili formalisht i

përfshin të gjitha standardet evropiane në këtë fushë.

Sa i përket qeverisjes së organeve publike, të përfshira me këtë analizë, situata është plotësisht e pabarabartë, përkatësisht ka shumë modele të ndryshme të qeverisjes dhe të , që do të tregohen në kuadër të analizës.

Ndërmarrje publike

Ndërmarrjet publike janë të rregulluara me Ligjin për ndërmarrjet publike. Ndërmarrjet publike themelohen me qëllim të kryerjes së veprimtarive me interes publik.

Ndërmarrje publike në emër të Republikës së Maqedonisë themelon Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në emër të komunës këshilli i komunës dhe në emër të Qytetit të Shkupit, Këshilli i qytetit të Shkupit.

Organe të ndërmarrjes publike janë: Këshilli drejtues, Drejtori dhe Këshilli drejtues.

Pagesat që paguhen për anëtarësi në këshillin drejtues i bën këshillet drejtuese atraktive për të gjithë që i plotësojnë kërkesat minimale ligjore.

Duke pasur parasysh mungesën e kriterëve përkatëse ligjore, si dhe për shkak të numrit të madh të anëtarëve, praktikisht është e pamundur në mënyrë profesionale dhe përkatëse të zbatohen në praktikë kompetencat të cilat i ka këshilli drejtues. Nga ana tjetër pagesa që paguhet për anëtarësi në këshillat drejtues, i bën këshillat drejtues atraktiv për çdonjërin që i përmbush këto kushte minimale ligjore. Në të vërtetë, nëse analizohen kompetencat e këshillave drejtues të përcaktuara në nenin 19 të Ligjit për ndërmarrjet publike, mund të konkludohet se të njëjtat kanë punë të lartë profesionale, respektivisht miratim të statutit, vendim për shpenzimin e mjeteve, përcaktim të politikës afariste, miratim të raporteve për punën dhe përcaktimin e vendosmërisë së strukturës organizative të ndërmarrjeve. Në bazë me nenin 17 të ligjit, këshilli drejtues i ndërmarrjes publike mund të përbëhet nga të paktën pesë, ndërsa më së shumti deri në 15 anëtarë, ku anëtarët e këshillit drejtues mund të

gjithë të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë të cilët kanë arsim të lartë, dhe nuk ka aktgjykim të plotfuqishëm me të cilin janë dënuar, kanë arsim të larë dhe kanë tre vjet përvojë pune.

Me punën e ndërmarrjes publike udhëheq drejtor, i cili e zgjedh ose e shkarkon Këshillin drejtues. Drejtori duhet të menaxhojë me punën e ndërmarrjes publike, por kushtet ligjore aspak nuk i përcaktojnë kompetencat e nevojshme në mënyrë që me sukses të realizohet kjo kompetencë. Në pajtim me nenin 24 paragrafi 5 të Ligjit për ndërmarrje publike, drejtori i një ndërmarrje publike e siguron zbatimin e vendimeve dhe të konkluzioneve të këshillit drejtues, merr pjesë në zbatimin e bazave të programit për punë dhe zhvillim, marrin pjesë në përcaktimin e kritereve për shfrytëzim dhe disponim me mjetet të realizuara me punën e ndërmarrjes publike dhe e bën koordinimin e aktivitetit afarist të ndërmarrjes publike dhe kryen veprime të tjera në lidhje me punën e ndërmarrjes të përcaktuara me statut. Në nenin 23 paragrafi 4 i Ligjit për ndërmarrjet publike, janë të përshkruara kushte identike për

drejtorin dhe ata për anëtarët e këshillave drejtues, me atë që në vend që të kërkohet tre vjet përvojë pune kërkohet pesë vjet përvojë pune, ndërsa si një kusht shtesë është njohja e anglishtes.

Kontrolli i punës materiale dhe financiare kërkon njohjen e çështjes së auditimit, gjë që nuk është e njohur nga Ligji për Ndërmarrjet Publike.

Për kryerjen e kontrollit të punës materiale - financiare të ndërmarrjes publike formohet këshill mbikëqyrës për kontrollin e veprimtarisë materiale - financiare (në tekstin e mëtejme: këshilli mbikëqyrës) i pesë anëtarëve. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës nuk mund të jetë më shumë se katër vjet. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës i emëron, përkatësisht i shkarkon themeluesi. Duke pasur parasysh kompetencat e këshillit mbikëqyrës, mund të konkludohet se ka mbivendosje të të njëjtave, me ato që duhet ti kenë revizorët në përputhje me Ligjin për kontrollin e brendshëm publik financiar. Me këtë rast duhet të kihet parasysh se kontrolli i punës materiale -

financiare kërkon njohje të plotë të kësaj çështjeje, diçka që Ligji për ndërmarrjet publike nuk e njeh aspak, për shkak të të cilës këto këshilla mbikëqyrëse nuk kanë kurrfarë funksioni të vërtetë në praktikë. Gjegjësisht, në pajtim me nenin 26 paragrafi 3 të Ligjit për ndërmarrje publike, kushtet për anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë identike me kushtet për anëtarë të këshillit drejtues. Ligji nuk përmban kurrfarë kriterë dhe kushte për shkarkim të anëtarëve të këshillave drejtuese dhe mbikëqyrëse.

Ndërmarrja publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" dhe Ndërmarrja publike "Radio televizioni i Maqedonisë" janë të rregulluara me dy ligje të veçanta.

Ligji për publikimin e ligjeve dhe dispozitave e akteve të tjera në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", është bazë ligjore për punën e NP "Gazet zyrtare të RM". Por ky ligj nuk përmban kurrfarë kushte për emërimin, as për shkarkimin e anëtarëve të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës, as për drejtorin. Për këtë arsye ekziston një boshllëk ligjor në këtë

ligj, e cila duhet të tejkalohet, përkatësisht ky ligj duhet të harmonizohet me ligjin e përgjithshëm, i cili e rregullon këtë materie. Ashtu si edhe në Ligjin për ndërmarrjet publike, edhe në këtë ligj nuk e ka përcaktuar merit procedurën për emërimin e anëtarëve të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës e as për drejtorin, përkatësisht nuk ekziston asnjë procedurë, e as detyrim për publikimin e shpalljes publike për emërimin e këtyre personave.

Ligji për shërbime mediatike audio dhe audio vizuale, është ligj i veçantë me të cilin rregullohet puna e RTM. Ky ligj në nenin 115, në mënyrë tërësisht të ndryshme e rregullon organizimin e kësaj ndërmarrje publike, e cila në vend të këshillit drejtues, ka këshill programor, dhe përveç drejtorit ka edhe zëvendës të tij. Me nenet 116, 125 dhe 130 të Ligjit janë përshkruar kriteret minimale për emërimin e anëtarëve të këshillit programor, këshillit mbikëqyrës, drejtorit dhe zëvendësit të tij, por këto kushte janë shumë të përgjithshme, dhe aspak nuk kanë të bëjnë me punën e RTM. Gjithashtu, me nenet 120, 128 dhe 131 janë të përshkruara edhe disa kushte themelore për shkarkimin e

anëtarëve të këshillit programor, këshillit mbikëqyrës, drejtorit dhe zëvendësit të tij. Në mënyrë shtesë ligji nuk përshkruan kurrfarë merit procedurë për emërimin e kandidatëve më të mirë. Ajo që gjithashtu mund të vërehet është se me ligjin parashihen kushtet dhe procedurat të përshkruhen me Statutin e RTM, të cili e miraton Këshilli programor, që është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë.

Shoqëritë tregtare

Shoqëritë tregtare në pronësi të plotë shtetërore janë të rregulluara me Ligjin për shoqëritë tregtare. Organe të shoqërive në pronësi të shtetit janë: këshilli i aksionarëve në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, përkatësisht, këshillit të shoqërisë në shoqatat aksionare.

Në nenin 231 – a nga Ligji për shoqëritë tregtare, janë përmbajtur kushtet për

emërimin e menaxhuesit, por për të gjitha çështjet e tjera nuk ka rregulla të qarta. Me këtë rast këto kushte janë të përgjithshme dhe identike për ato për drejtor të ndërmarrjeve publike (nënshtetësi, arsimit i lartë, pesë vjet përvojë pune, të mos jenë të dënuar dhe njohja e gjuhës angleze). Dhe këtu nuk kërkohen kompetenca të cilat janë të nevojshme për tu menaxhuar këto shoqëri, në të cilat shteti është pronar i plotë. Në shoqëritë tregtare në pronësi të plotë shtetërore nuk ka kurrfarë rregulla as në raport me punësimin e punëtorëve, sepse aplikohet ligji për marrëdhënie pune, për shkak të të cilës këto shoqëri janë formë më e përshtatshme për punësime partiake, pa kritere të qarta.

Ligji nuk përmban kurrfarë kritere për shkarkimin e organeve të menaxhimit dhe udhëheqjes në shoqëritë tregtare në pronësi të plotë shtetërore.

Ligji për shoqëritë tregtare, në një kapitull të veçantë i parashikon të ashtuquajturat shoqëri në pronësi të shtetit dhe shoqërive me pjesëmarrje shtetërore. Megjithatë, për këto shoqëri nuk mund të thuhet se janë forma të veçanta të shoqërive tregtare, por

ato përfaqësojnë një lloj të veçantë, duke pasur parasysh subjektin që paraqitet si themelues, përkatësisht pjesëmarrës me letra komerciale ose aksion të caktuar. Ashtu, neni 660 nga, ligji i përcakton llojet e shoqërive në të cilin qëndron se "Republika e Maqedonisë mund të themelojë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëri aksionare në pronësi shtetërore. Shoqëritë në pronësi të shtetit në të cilat Republika e Maqedonisë i ka fituar këto letra komerciale, përkatësisht aksione".

Nëse bëhet analizë komparative të legjislativit tonë me legjislativin e Republikës së Kroacisë dhe të Republikës së Sllovenisë, mund të shihet se ekzistojnë dallime në raport me rregullimin e ndërmarrjeve publike.

Për dallim nga Republika e Maqedonisë, në Kroaci të gjitha ndërmarrjet publike janë të rregulluara me Ligjin për shoqëritë tregtare.¹ Në këtë ligj askund nuk ka rregulla shtesë për ndërmarrjet publike në

pronësi të plotë ose dominante shtetërore. Ajo do të thotë se ndërmarrjet publike kanë status identik si të gjitha shoqëritë e tjera tregtare, si në aspektin e menaxhimit, ashtu edhe në aspektin e punës materiale - financiare. Nga të dhënat e Ministrisë së financave të Republikës së Kroacisë, mund të shihet se në vitin 2016 ka pasur 54 ndërmarrje shtetërore.² Nëse merren parasysh të gjitha ndërmarrjet publike në Kroaci, përfshirë edhe ato që janë themeluar nga komuna, në Kroaci në vitin 2016 ka pasur 1149 ndërmarrje publike.³ Në Kroaci ndërmarrje publike janë ato në të cilat shteti (qendror, federal, lokal ose rajonal) ka pronësi të plotë, dominuese ose të pakicës. Ndërmarrjet publike mund të organizohen si shoqëri aksionare ose si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Ato janë të ndara në financiare dhe jofinanciare. Ndërmarrjet financiare publike janë kryesisht institucione financiare publike si banka qendrore, banka shtetërore e zhvillimit dhe institucione të tjera të ngjashme financiare që kryejnë shërbime financiare dhe fiskale

¹ https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2011_12_152_3144.html

² <http://www.mfin.hr/hr/financijska-izvjesca-javna-poduzeca-2016>

³ <https://www.ijf.hr/upload/files/5.pdf>

për shtetin. Ndërmarrjet jofinanciare publike sigurojnë në parime jo-tregtare, me çka shkelet konkurrenca çmimore në tregun. Në vitin 2013, Qeveria themeloi ndërmarrje dhe entitete të tjera juridike me interes strategjik dhe të veçantë, në të cilin shteti (si aksionar) realizon qëllime ekonomike dhe strategjike. Ligji nuk përmban kritere të qarta për zgjedhje dhe shkarkim të organeve administrative dhe të menaxhimit të shoqërive komerciale shtetërore në Kroaci.

Gjithashtu si në Kroaci ashtu edhe në Slloveni, ndërmarrjet publike themelohen si shoqëri tregtare. Ndërmarrjet publike në pronësi të plotë dhe të pjesëshme shtetërore janë të pranishme në shumicën nga industritë në Slloveni. Shteti kurrë nuk ka qenë e nënshtruar në programin për privatizim me shumicë, duke mbajtur aksione të konsiderueshme pronësore në shumë kompani të mëdha që nga pavarësimi i saj. Në sektorë që konsiderohen me interes kombëtar strategjik dominojnë ndërmarrjet shtetërore, siç janë energjetika, transporti, bankieri dhe sigurimi. Sektorët e tjerë të ekonomisë, duke i përfshirë edhe shitjen me pakicë, argëtimin, ndërtimin, turizmin

dhe prodhimin, përfshijnë kompani të rëndësishme që janë tërësisht në pronësi shtetërore ose në të cilat shteti ka një interes kontrollues duke pasur parasysh se e posedon bllokun më të madh të aksioneve. Marrë në përgjithësi, ndërmarrjet shtetërore nuk marrin pjesë më të madhe të kontratave / aktiviteteve afariste nga konkurrentët e sektorit privat në sektorët e hapur për konkurrencën private dhe të huaj. Kompanitë sociale marrin të mira dhe shërbime nga kompanitë private dhe të huaja. Ndërmarrjet shtetërore patjetër duhet ta ndjekin ligjin e rreptë për prokurimin publik që kërkon procedura transparente të qasshme për të gjitha firmat. Firmat private mund të garojnë sipas të njëjtave kushte në lidhje me pjesëmarrjen e tregut, prodhimet dhe stimulimet. Të gjitha firmat e kanë të njëjtën qasje në financimin. Ndërmarrjet publike u nënshtrohen ligjeve të njëjta si kompanitë private. At janë të detyruara ti paraqesin librat e tyre për auditime të pavarura dhe të publikojnë raporte vjetore nëse është ato janë të nevojshme. Standardet për raportim janë të krahasueshme me standardet ndërkombëtare për raportim financiar. Ndërmarrjet shtetërore duhet patjetër

ti respektojnë të gjitha obligimet ligjore. Sllovenia është anëtare e Marrëveshjes për furnizime publike (GPD) në kuadër të OBT. Ndërmarrjet publike janë të përfshira me marrëveshjen. Ligjet nuk përmbajnë kriteret të qarta për zgjedhje dhe shkarkim të organeve menaxhuese dhe udhëheqëse në pronësi të plotë shtetërore.

Duke i vijuar rekomandimet e OECD, qeveria e themeloi Agjencinë për menaxhim me mjete kapitale (AMMK) në nëntor të vitit 2010 për ta rritur transparencën dhe që të promovojë menaxhim më efikas me SOE. Në vitin 2013, pushtetet e transformuan AMMK ne Holding shtetëror të Sllovenisë (HSHS). Më shumë se 95 përqind nga fondet të HSHS investohen në vend. HSHS është organ i pavarur shtetëror i cili përgjigjet para Kuvendit Nacional të Republikës së Sllovenisë. Dërgon në kuvendin nacional raporte vjetore në lidhje me zbatimin e Planit vjetor për menaxhim korporativ me investimet kapitale nga viti paraprak. Qeveria mandej e miraton Planin vjetor për menaxhim korporativ me investime kapitale në sajë të propozimit të HSHS.⁴

Trupat rregullatore, organet shtetërore dhe organet e administratës shtetërore

Analiza e ligjeve me të cilat rregullohet puna dhe veprimi, emërimi i anëtarëve të trupave drejtuese dhe drejtorëve të trupave të pavarura rregullatore, trupave shtetërore dhe organeve të administratës shtetërore, tregon një heterogjenitet të madh në raport me rregullativën. Megjithatë nuk ekziston parim universal e as zgjidhje sistimore ligjore në raport me mënyrën në të cilën rregullohet udhëheqja dhe menaxhimi e këtyre institucioneve publike.

Në shtetin janë të vendosura dhe funksionojnë dhjetë trupa rregullatore dhe atë: Agjencia për shërbime audio dhe audio vizuale mediale, Agjencia për telekomunikime elektronike, Agjencia për posta, Agjencia për rregullimin e sektorit

⁴ <https://www.export.gov/article?id=Slovenia-State-Owned-Enterprises>

hekurudhor, Agjencia për supervizion të sigurimit kapital financiar kapital pensional, Agjencia për supervizion të sigurimit, Agjencia për fluturime civile, Komisioni për letra me vlerë, Komisioni rregullator për banim, Komisioni rregullator për energjetikë. Siç mund të shihet, nga dhjetë trupa rregullatore, shtatë janë të themeluara si agjenci, ndërsa tre si komisione. Me këtë rast mënyra e udhëheqjes me trupat rregullatore është e ndryshme. Ajo që është karakteristike është se të gjitha trupat rregullatore kanë organ kolektiv të drejtimit (këshill, këshill të ekspertëve, komision ose këshill drejtues) dhe organ udhëheqës emergjent. Me agjencitë udhëheq drejtor, ndërsa në disa nga këto agjenci ka edhe zëvendës të drejtorit. Me komisionet udhëheq kryetar. Duke pasur parasysh faktin se këto trupa rregullatore janë të themeluara para së gjithash për harmonizimin e legjislativ vendor me standardet ndërkombëtare, e para së gjithash me legjislativin e UE (acquis communautaire), mund të vërehet se te të gjithë rregullatorët ka kushte ligjore për zgjedhje të organit të udhëheqjes (këshill, këshill të ekspertëve, këshill drejtues ose komision). Kushtet për zgjedhje të anëtarëve të udhëheqjes

(drejtor, zëvendës drejtor, përkatësisht kryetar) janë më të përgjithshme se sa ato për organin udhëheqës. Këto ligje përmbajnë edhe kushte për shkarkim të organeve udhëheqëse, ose janë të ndërlidhura para së gjithash me kushtet e përgjithshme ligjore për pushim të marrëdhënies së punës (vdekje, pensionim, humbje të aftësisë afariste, vuajtje e dënimit me burg mbi gjashtë muaj). Në mënyrë shtesë i përmbajnë edhe raste të konfliktit të interesit për shkak të të cilave një person i caktuar nuk mund të jetë organ udhëheqës në trupat rregullatore.

Ajo që mungon në të gjitha këto ligje është mungesa e procedurës fer, transparente dhe merit (sipas meritave) për zgjedhje të anëtarëve të organit të menaxhimit dhe organit menaxhues. Ekziston obligim për publikim të shpalljes publike, mirëpo nuk ekziston kurrfarë procedure në të cilën, kandidati më i mirë do ishte zgjedhur anëtar i organit të udhëheqjes, përkatësisht të organit udhëheqës.

Ajo që mungon në të gjitha këto ligje është procedurë e drejtë, transparente dhe e bazuar në meritë e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit drejtues dhe të organeve drejtuese. Ekziston detyrim për të publikuar njoftim publik, por nuk ekziston asnjë procedurë përmes së cilës kandidati më i mirë do të zgjidhet si anëtar i organit drejtues, përkatësisht trupit menaxhues.

Në të gjitha këto trupa rregullatore, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është kompetent për zgjedhje të anëtarëve të organit të udhëheqjes, ndërsa organi i udhëheqjes është ai që e emërton organin udhëheqës. Duke pasur parasysh kompetencat rregullatore të cilat duhet ti kenë këto trupa, vendosja e këtyre përkon me nevojat.

Prapëseprapë nëse analizohen kompetencat ligjore, mund të konkludohet se Agjencia për rregullimin e sektorit hekurudhor si dhe Komisioni rregullator për banim, nuk kanë kompetenca të qarta rregullatore, përkatësisht të njëjtat janë

organet që janë kompetente vetëm për zbatimin e ligjeve, për shkak të të cilës është kontestuese edhe vendosmëria e tyre në sistemin e organeve shtetërore. Të gjitha ligjet përmbajnë kushte themelore për shkarkimin e drejtorëve dhe anëtarëve të organeve të udhëheqjes, të cilët pjesërisht janë të ndërlidhura edhe me performancën e tyre.

Nëse bëhet krahasim komparativ mund të konkludohet se edhe në Republikën e Kroacisë, si në Republikën e Maqedonisë, janë formuar më tepër trupa rregullatore. Këto trupa rregullatore formohen si agjenci dhe komisione. Nga analiza e mënyrës së udhëheqjes të Agjencisë Kroate Rregullatore Energjetike (AKRE)⁵ dhe Agjencia Kroate Rregullatore për Punë të Rrjetëve (AKRRPRR)⁶, mund të konkludohet se edhe në Kroaci, njëlloj si në Maqedoni ka mënyrës të ndryshme për udhëheqje me këto trupa rregullatore. Gjegjësisht në AKRE ka këshill drejtues i cili udhëheq me Agjencinë, ndërsa në AKRRPRR ka kuvend, i cili zgjedh drejtor që udhëheq me shërbimin profesional. Në të dy rastet Kuvendi i Republikës së Kroacisë është ai që i zgjedh anëtarët e këshillit

⁵ https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2012_10_120_2584.html

⁶ https://www.hakom.hr/UserDocsImages/2011/propisi_pravilnici_zakoni/1.%20Zakon%20o%20elektroni%C4%8Dkim%20komunikacijama%20NN%2073_08.pdf

drejtues përkatësisht të kuvendit, me ç'rast ka kritere mjaft të larta për kandidatët. Në përgjithësi legjislativi ynë është i ngjashëm me atë në Kroaci, në raport me trupat rregullatore.

Në të gjitha rastet procedura parasheh publikimin e një njoftimi publik, por në asnjë nga rastet nuk është përcaktuar procedura për zgjedhje të drejtë, transparente dhe meritore të atyre pozitive qeverisëse. Kriteret për shkarkim janë në lidhje me ndërprerjen e punësimit, në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve të Punës (vdekja, moshja, dhe gjashtë muaj burgim, humbja e aftësisë afariste ose dorëheqja). Nuk ka kushte për shkarkim bazuar në performancën e dobët.

Edhe në Republikën e Sllovenisë, njëlloj si edhe në Republikën e Maqedonisë, janë formuar më tepër trupa rregullatore. Këto trupa rregullatore formohen si agjenci dhe komisione. Nga analiza e mënyrës së udhëheqjes së Agjencisë për Rrjete dhe Shërbime Komunikuese (AKOS)⁷ dhe Agjencisë për Siguri të Tregut (ATVP),

mund të konkludohet se në Slloveni, trupat rregullatore janë të udhëhequra nga këshill dhe nga drejtor. Në të dy rastet Kuvendi i Republikës së Sllovenisë është ai që i zgjedh anëtarët e këshillit, me ç'rast ka kritere mjaft të larta për kandidatët. Këshilli e cakton drejtorin. Në përgjithësi legjislativi ynë është i ngjashëm me atë në Slloveni, në raport me trupat rregullatore.

Nga kjo mund të nxirret konkluzë se në raport me trupat rregullatore legjislativi ynë është në masë të madhe i ngjashëm me atë të Kroacisë dhe të Sllovenisë, të cilat janë vende anëtare të UE. Prapëseprapë duhet të kihet parasysh se edhe shteti ynë, si Kroacia dhe Sllovenia kanë trashëgimi identike juridike, për shkak të të cilës këto trupa rregullatore janë risi në sistemet tona, dhe nga kjo debati publik rreth rregullimit sistemor të këtyre organeve të reja në sistemet tona juridike çdokund zhvillohet.

Organet e pavarura shtetërore janë ato të cilat sipas kompetencave të veta i takojnë kryesisht pushtetit ekzekutiv, por për shkak të specifikave të atyre kompetencave duhet të kenë shkallë të veçantë të pavarësisë, ku për nga ana hierarkike të

⁷ https://www.akos-rs.si/files/APEK_eng/Legislation/electronic-communications-act-zekom1.pdf

njëjtat janë të subordinuara nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, e jo nga Qeveria. Në fakt është nisur nga supozimi se këto organe do të kenë pavarësi më të madhe nëse përgjigjen para Kuvendit. Dhe në raport me pjesën e madhe të këtyre organeve ekzistojnë standarde ndërkombëtare të cilat kërkojnë pavarësi të plotë të pjesës së këtyre organeve posaçërisht në fushat e mbrojtjes së të dhënave personale, revizionit, mbrojtjes së konkurrencës, pengimit të korrupsionit, furnizimet publike, zgjedhjet e ngjashëm.

Në pajtim me legjislacionin në republikën e Maqedonisë, janë themeluar dhjetë organe të pavarura shtetërore dhe ato janë Agjencia për administratë, Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale, Enti shtetëror për revizion, Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Komisioni shtetëror për ankesa për furnizime publike, Komisionit shtetëror për vendosje në shkallë të dytë fushën e mbikëqyrjes së inspektimit dhe për procedura kundërvajtëse, Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedure administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, Komisioni për qasje të lirë

në informacione me karakter publik dhe Komisioni për mbrojtje të konkurrencës. Njëlloj si edhe në raport me trupat rregullatore, ashtu edhe në raport të organeve të pavarura shtetërore, ka tre lloje të organeve që janë të vendosura, e ato janë agjenci, ent dhe komision. Agjencitë janë të udhëhequra nga drejtor dhe zëvendës drejtor. Enti shtetëror për revizion është i udhëhequr nga revizori kryesor shtetëror i cili ka zëvendës të tij. Komisionet janë të përbëra nga anëtarë, ndërsa i udhëheq kryetar. Kushtet ligjore për zgjedhje të drejtorëve dhe të zëvendësve të tyre, përkatësisht për anëtarë të komisionit janë identike, përkatësisht kërkohet së kandidatët të jenë shtetas, të kenë arsim të lartë, të kenë përvojë të caktuar pune, të mos u jetë shqiptuar ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose të detyrës dhe të njohin nivele të caktuara të gjuhës së huaj. Në këtë pjesë ekziston edhe një organ, e ai është Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, në të cilin anëtarët përcaktohen nga partitë politike, në sajë të shpërndarjes ligjore të numrit të anëtarëve, që do të thotë se bëhet fjalë për organ tërësisht politik, në të cilin nuk kërkohet kurrfarë ekspertize dhe kompetence,

pa marrë parasysh se ky organ është kompetent për njërin nga proceset më të rëndësishme demokratike në shtet, e ato janë zgjedhjet.

Agjencioni për të rinj dhe sport dhe Agjencioni i mërgatës rrjedhin drejtpërdrejt nga Ligji për organizim dhe punë të organeve shtetërore. Ndërkohë, nuk ka rregullore për atë se kush do të menaxhojë këto organe, si dhe nuk ka ndonjë lloj kushti ligjor për përzgjedhjen e menaxherëve.

Në të gjitha rastet është paraparë të shpallet njoftim publik, por në asnjë rast nuk është përshkruar një procedurë fer, transparente dhe e merit për përzgjedhjen në këto poste udhëheqëse. Kushtet për shkarkim kanë të bëjnë me ndërprerjen e punësimit në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune (vdekje, pension pleqërie, dënim me burgim gjashtëmujor, humbje të aftësisë afariste ose dorëheqje). Askund nuk ka kushte për shkarkim bazuar në performancën e dobët.

Në qoftë se ndërkaq bëhet analizë e kompetencave ligjore të këtyre organeve të pavarura shtetërore, mund

të konkludohet se të njëjtat janë pjesë e pushtetit ekzekutiv, jo të atij ligjvënës, me ç'rast tre nga këto organe (Agjencia për administratë, Komisioni shtetëror për vendimmarrje në shkallë të dytë në fushën e inspektimit dhe procedurës për kundërvajtje dhe Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurat administrative dhe procedurat nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë) është e nevojshme të rivlerësohet vendosja e tyre sistemore, për shkak se nga puna e tyre efikase në mënyrë të drejtpërdrejtë varet në punën e Qeverisë, e cila nuk ka kurrfarë mekanizmi formal me kontrollin e punës së tyre.

Në raport me përvojat komparative, mund të konkludohet se edhe në Republikën e Kroacisë, si edhe në Republikën e Maqedonisë ka më shumë organe të pavarura shtetërore. Për analizë është marrë Agjencia për mbrojtje të të dhënave personale.⁸ Kjo Agjenci është e udhëhequr nga drejtor dhe zëvendësi i tij, të cilët i emërton dhe i shkarkon Kuvendi i Republikës së Kroacisë, dhe për të cilat janë të përshkruara kritere ligjore për zgjedhje, të cilat janë të ngjashme me kriteret e rregullativës sonë. Edhe në Kroaci mungojnë kritere për shkarkim të

⁸ https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2018_05_42_805.html

bazuara në performancën e keqe.

Në Republikën e Sllovenisë, njëlloj si edhe në Republikën e Maqedonisë ka më shumë organe të pavarura shtetërore. Për analizë është marrë Komisioni për antikorrupsion.⁹ Ky Komision është i udhëhequr nga kryetar, i cili ka dy nënkryetarë, ndërsa për emërtimin e anëtarëve të Komisionit janë përkrahur kritere precize ligjore për zgjedhje, për dallim nga ligji ynë i cili përmban kritere minimale ligjore. Edhe në Slloveni mungojnë kritere për shkarkim të bazuara në performancën e keqe.

Mos-konsekuencat më të mëdha ligjore në lidhje me rregullimin e punës dhe veprimtarisë, emërimin të anëtarëve të këshillave drejtuese dhe drejtorëve ka te organet e pavarura të administratës shtetërore. Nga analiza e rregullativës rezulton se në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë 30 organe të pavarura të administratës shtetërore, të cilat janë të rregulluara me 28 ligje. Këto organe janë themeluar si agjenci, drejtori, komisione, institute, ente, komitete, një trup revizioni dhe organ kontrolli dhe prokuroria shtetërore. Nuk ekziston një mënyrë e vetme për menaxhimin dhe udhëheqjen

me këto organe, por më shpesh të njëjtat janë të udhëhequra nga drejtor, i cili ka zëvendës, ndërsa me komisionet udhëhiqen nga kryetar, me trupin e revizionit udhëheq revizori kryesor i cili ka zëvendës të tij, me nga një president, organi i kontrollit kryesohet nga një auditor kryesor me një deputet, me avokatinë e shtetit udhëheq avokati i shtetit. Te disa nga këto organe madje ka edhe këshilla drejtues, edhe pse nuk ka kurrfarë kritere ligjore sipas të cilave do të përcaktohej në cilat raste është i nevojshëm këshilli drejtues. Nëse analizohen kompetencat ligjore të organeve të pavarura të administratës shtetërore, mund të konkludohet se të njëjtat janë ekzekutues të rëndomtë të ligjeve, prandaj ekzistenca e këshillave drejtues në këto organe është e pakuptimtë.

Për sa i përket rregullativit ligjor duhet të theksohen Agjencia për të rinj dhe sport, Agjencia e mërgatës dhe Komisioni për Marrëdhëniet me komunitetet fetare dhe grupet religjioze, të cilat nuk kanë ligj material sipas të cilit janë themeluar. Në fakt Agjencioni për të rinj dhe sport dhe Agjencia për mërgatën drejtpërdrejtë burojnë nga Ligji për organizim dhe

⁹ <https://www.kpk-rs.si/en/commission/about-us/>

punë të organeve shtetërore. Gjatë asaj askund nuk është e rregulluar kush do të udhëheq me këto organe, e as që ka çfarë do qoftë kushte ligjore për zgjedhje të personave udhëheqës. Por edhe përkundër zbrastërës ligjore në praktikë këto dy agjenci përveç drejtorit kanë një zëvendësdrejtor, me ç'rast në këtë pozicion mund të caktohet kush do qoftë pa kurrfarë procedurë ligjore. Nga ana tjetër, Komisioni për marrëdhënie me komunitetet fetare dhe grupet religjioze vepron pa asnjë bazë ligjore, që do të thotë se për këtë komision nuk ekzistojnë kurrfarë kushte ligjore për kryetar dhe anëtarë, nuk ka kompetenca ligjore, nuk ka status juridik, përkatësisht i njëjti funksionon vetëm në bazë të praktikës së vendosur ligjore e cila nuk është burim i të drejtës në sistemin tonë ligjor.

Në të gjitha rastet e tjera, organet e pavarura të administratës shtetërore janë të vendosura me ligje të veçanta, me ç'rast për emërimin e drejtorit dhe zëvendësit të tij parashikohet të shpallet një konkurs publik, por në asnjë rast nuk është përshkruar një procedurë fer, transparente dhe merit procedurë për përzgjedhjen e këto pozita udhëheqëse. Kushtet për shkarkim janë identike edhe

për organet rregullatore, përkatësisht nuk lidhen me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune (vdekje, pension pleqërie, dënim gjashtëmujor me burg, humbje e aftësisë afariste ose dorëheqje). Askund nuk ka kushte për shkarkim të bazuara në performancën e dobët.

Në Drejtorinë për zona teknologjike industriale zhvillimore, Institutin për akreditim, Institutin për akreditim, Institutin për standardizimi, Agjencinë Nacionale për programe evropiane arsimore dhe mobilitet, Agjencinë për energjetikë, Agjencinë për kadastrë të patundshmërive, Agjencinë për planifikim të sipërmarrësisë, Agjencinë për nxitje të zhvillimit të bujqësisë, Agjencinë për promovim dhe përkrahje të turizmit, Agjencinë për investime të huaja dhe promovim të eksportit, Agjencinë për menaxhim me pronën e konfiskuar dhe Agjencinë për film është paraparë që krahas drejtorit dhe/ose zëvendës drejtorit, si organ i menaxhimit të caktohet edhe këshill drejtues ose trup tjetër kolektiv i menaxhimit. Në këto organe, organi i menaxhimit është ai që e zgjedh dhe shkarkon drejtorin, përkatësisht zëvendësin e tij. Nuk ka kurrfarë shpjegimi logjik përse në këto organe ka një organ

kollektiv të menaxhimit, ndërsa në organet e tjera të administratës shtetërore nuk ka. Ekzistojnë kërkesa minimale ligjore për përzgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organit drejtues, të cilat janë identike me ato të Ligjit për marrëdhënie pune.

Si në Republikën e Maqedonisë, ashtu edhe në republikën e Kroacisë ka një numër të madh të organeve të administratës shtetërore. Këto organe kanë shumë emërtime të ndryshme por emërtimi më i shpeshtë i organeve të pavarura e administratës shtetërore është kancelari (zyrë), por ka edhe komisione dhe drejtori. Kancelaritë janë të themeluara për punë të ndryshme dhe atë në marrëdhëniet ndëretnike, barazi të gjinive, refugjatë, kufij, pakica nacionale, të drejtat e njeriut, ndrydhje të keqpërdorimit të drogës dhe fusha të tjera. Nuk ka kriteret të qarta ligjore sipas të cilave do të bëhet zgjedhje dhe shkarkim të personave udhëheqës në këto organe.

Në Republikën e Sllovenisë nuk ka organe të pavarura të administratës shtetërore. Në fakt në pajtim me ligjin për administratë publike¹⁰ në pajtim me këtë

ligj, në Republikën e Sllovenisë këshillat drejtues i kryejnë ministrinë, organet në përbërje të ministrive dhe njësitë administrative. Ministrinë formohen për të bërë punë administrative në një ose më tepër fusha administrative. Organet në përbërje të ministrive themelohen për të kryer detyra të specializuara që kërkojnë ekspertizë, çështje ekzekutive dhe zhvillimore administrative, punë inspektuese inspektime dhe çështje të tjera mbikëqyrëse dhe punë në lidhje me shërbimet publike, nëse kjo siguron efikasitet dhe cilësi më të lartë në zbatimin ose nëse është e nevojshme një shkallë më të lartë e ekspertizës dhe e pavarësisë për shkak të natyrës së çështjeve administrative. Njësitë administrative formohen për kryerje të çështjeve administrative për të cilat është i nevojshëm organizim dhe funksionim territorial. Ky është një koncept krejtësisht i ndryshëm nga i yni, i cili për shkak të vendosjes së rreptë hierarkike, llogaridhënies dhe përgjegjësisë është shumë më efikas. Ndërkaq nuk ka kurrfarë kushte ligjore për emërimin e drejtuesve të këtyre organeve.

¹⁰ <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/UNTC/UNPAN015728.pdf>

Rezyme dhe rekomandime

—

Nga analiza e legjisllacionit të përgjithshëm me të cilat janë të rregulluara ndërmarrjet publike, ndërmarrjet në pronësi të plotë shtetërore, organet e pavarura rregullatore, organet shtetërore dhe organet e administratës shtetërore, rezulton se nuk ka rregullim sistemor të punës dhe veprimit, emërim i anëtarëve të këshillave drejtuese dhe drejtorëve në këto institucione të sektorit publik, siç nuk ka rregullim sistemor dhe as vendosje organizative horizontale dhe vertikale të këtyre institucioneve publike.

Në raport me ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të plotë shtetërore, ekziston një dualizëm në rregullativën, edhe pse edhe njërat edhe tjerat kryejnë veprimtari ekonomike. Në të vërtet për dallim nga Republika e Kroacisë dhe Republika e Sllovenisë, ku të gjitha ndërmarrjet publike e kanë statusin e shoqërive tregtare, që do të thotë se në kushte të barabarta ata kryejnë veprimtarinë për të cilën ata janë

themeluar, në Republikën e Maqedonisë ndërmarrjet publike kanë status të ndryshëm nga kompanitë tregtare. Në të vërtetë 109 ndërmarrje publike kanë një regjim të ndryshëm ligjor për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve udhëheqëse, mbikëqyrëse dhe menaxheriale dhe regjime të ndryshëm ligjor lidhur me punësimin e kuadrit, megjithëse të njëjtit duhet të kryejnë veprimtari ekonomike.

Ligji për Ndërmarrjet publike i përshkruan kushtet minimale ligjore për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillave drejtuese dhe mbikëqyrëse dhe të drejtorëve, të cilët nuk e pasqyrojnë nevojën reale dhe nuk korrespondojnë me kompetencat që duhet ti kryejnë këto organe.

Trupat rregullatore gjithashtu nuk janë të rregulluara në mënyrë sistemore, përkatësisht të njëjtat janë të vendosura kryesisht për qëllim të harmonizimit të legjisllacionit nacional me legjisllacionin e BE. Në ato janë të vendosura kushte më të detajuara për përzgjedhjen dhe shkarkimin e organeve udhëheqëse dhe të menaxhimit në këto organe.

Organet e pavarura shtetërore si dhe organet e administratës shtetërore janë të rregulluara me ligje të veçanta, të cilat përmbajnë kriteret minimale ligjore për përzgjedhjen dhe shkarkimin e organeve drejtuese dhe qeverisëse. Te organet e caktuara mund të vërehet mospërputhja e vendosjes së tyre vertikale, përkatësisht duhet të rishqyrtohet vendosja aktuale vertikale. Në kuadër të analizës janë përcaktuar tre organe në të cilat nuk ka kurrfarë rregullativë ligjore as në aspektin e menaxhimit e të njëjtave e as në lidhje me kushtet e personave udhëheqës.

Ajo që është konkluzë e përgjithshme është se çdokund mungon procedurë fer, transparente dhe merit procedurë për zgjedhje të organeve udhëheqëse, drejtuese dhe mbikëqyrëse.

Rekomandime

Me qëllim të tejkalimit të gjendjes së përcaktuar, nevojitet që të ndërmerren aktivitetet vijuese:

- 1. Të rivlerësohet statusi juridik i ndërmarrjeve publike, në raport me shoqëritë tregtare në pronësi të plotë shtetërore.***
- 2. Të rivlerësohet mënyra e menaxhimit dhe mbikëqyrja e punës mbi të gjitha organet e krijuara në të cilat janë të vendosura dhe veprojnë këshillat udhëheqëse dhe mbikëqyrëse, si nga aspekti i kualifikimeve profesionale të cilat duhet ti kenë njerëzit të cilët do të emërohen në këto organe, ashtu dhe nga aspekti i kryerjes efikase të kompetencave juridike të këtyre organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse në mënyrë efikase dhe ekonomike.***

3. *Të vendoset legjislacionit sistemor në lidhje me trupat rregullatore.*
4. *Të përcaktohen kushte të sakta ligjore për zgjedhje dhe shkarkim të personave drejtues të organeve shtetërore, të cilat do të jenë të ndërlidhura juridiksonin e këtyre organeve, si dhe me performancën e këtyre personave në punën e tyre.*
5. *Të përshkruhet procedurë fer, transparente dhe merit procedurë për zgjedhje të kandidatëve në pozicione udhëheqëse.*
6. *Të bëhet analizë vertikale dhe horizontale ligjore e kompetencave të trupave rregullatore, organet e pavarura shtetërore dhe organet e administratës shtetërore, nga të cilat do të burojnë rekomandime për riorganizimin e brendshëm të këtyre institucioneve.*

Informacion mbi IDSCS

IDSCS është think tank - organizatë civile që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, shtetin e së drejtës dhe integrimin evropian të Maqedonisë. IDSCS ka për mision ndihmën e angazhimit qytetar në vendimmarrje dhe për të forcuar kulturën pjesëmarrëse politike. Duke zhvilluar vlerat liberale, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën midis diversitetit.

Informatat kontaktuese për IDSCS

Adresë: Str. Teodosij Gologanov Nr. 42A / 3 dhe 42A / 4, 1000 Shkup
Telefoni / Fax: +389 2 3094760
E-Mail: contact@idscs.org.mk

Informacion rreth autorëve

Jugoslav Gjorgjievski ka diplomuar në Fakultetin Juridik "Iustinianus Primus" në Shkup në vitin 2005 si student i tretë në gjeneratën e tij. Ai ka dymbëdhjetë vjet përvojë pune në reformën e administratës, së pari si nëpunës civil në Ministrinë e Drejtësisë, në Inspektoratin Shtetëror Administrativ dhe në Ministrinë e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës, dhe pastaj dhe si konsulent. Ka punuar në shumë ligje dhe rregullore në fushën e procedurave administrative, statusin e zyrtarëve, organizimin e organeve shtetërore, shërbimet e inspektimit etj.

Informacione rreth projektit

Projekti “Drejt qeverisjes së mirë në ndërmarrjet shtetërore dhe organet e pavarura shtetërore” (Improved good governance of state owned enterprises and independent state bodies) financohet nga Mbretëria e Bashkuar përmes Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Projekti analizon performancën e ndërmarrjeve publike, ndërmarrjeve shtetërore dhe organeve të pavarura shtetërore në lidhje me atë se sa adekuate janë menaxhimi dhe procedurat e menaxhimit dhe vlerëson nëse ka procedura të cilat krerët e këtyre institucioneve i bëjnë rezistent ndaj klientelizmit dhe korrupsionit. Qëllimi është të iniciohen ndryshime në kulturën qeverisëse të institucioneve të synuara që do të kontribuonin në zhvillimin e tyre afatgjatë dhe të qëndrueshëm dhe do të siguronin bazë për raportim më të mirë të brendshëm.

Link

Ky publikim është në dispozicion në:

-

<https://idscs.org.mk/mk/portfolio/kriteret-ligjore-per-emerimin-e-udheheqesve-te-ndermarrjeve-publike-organeve-rregullatore-dhe-te-pavarura/>

Studim i shkurtër i
politikave 19/2018

Kriteret ligjore për emërimin e udhëheqësve të ndërmarrjeve publike, organeve rregullatore dhe të pavarura

Autorët: Jugoslav Gjorgjievski

-

Nëntor 2018



British Embassy
Skopje

